



Kosovo Career
Development Foundation

BUSÛLLA

FUSHËVEPRIMTARIA DHE OBJEKTIVAT E ORGANIZATËS



PËRGATITUR NGA KCDF

Rreth Fondacionit / Forumit Kosovar për Zhvillim të Karrierës

Organizatë jo-qeveritare që promovon edukimin dhe orientimin për karrierë, ndërmarrësinë dhe ndërlidhjen e sistemit arsimor me tregun e punës.

Palët kryesore të interesit dhe partnerët e organizatës janë: Ministrinë, Drejtorinë Komunale të Arsimit, organizatat ndërkombëtare (ASSET-USAID, GIZ, SDC, HELVETAS, LuxDev, ADA, Solidar Suisse), institucionet arsimore dhe bizneset.



Rreth Fondacionit / Forumit Kosovar për Zhvillim të Karrierës (vazhdim)

Në vijim janë objektivat kryesore të organizatës tonë:



Promovimi dhe ofrimi i shërbimeve për orientim në karrierë te të gjitha institucionet arsimore, mësimdhënësit, prindërit, bizneset dhe shoqatat e bizneseve.




Realizimi i analizave gjithëpërfshirëse të arsimit dhe indikatorëve të tregut të punës për t'i njoftuar palët e interesit.



Organizimi i Forumit Nacional për Edukim dhe Orientim në Karrierë.



Sigurimi i shërbimeve të edukimit për karrierë përmes Busulla.COM



Busulla.COM është platforma nacionale për këshillim dhe orientim në karrierë dhe orientim profesional të nxënësve në tregun e punës.

- A. Ndhmon nxënësit të marrin vendime të mirinformuara për shtegun e karrierës.
- B. Shfrytëzon potencialin dhe prirjet duke rritur produktivitetin dhe kualitetin e jetës.
- C. Ofron qasje në informata relevante për nxënës dhe prindërit e tyre dhe trende që kanë të bëjnë me interesat e të rinjve.

**Sigurimi i shërbimeve të
edukimit për karrierë
përmes Busulla.COM
(vazhdim)**

Këto shërbime kanë përmirësuar transparencën dhe konkurrencën në mes shkollave duke tërhequr nxënësit për regjistrim, veçanërisht midis shkollave profesionale në përmirësimin e profileve, marketingut, etj.

Bizneset kuptojnë se si bashkëpunimi me shkolla shpie te një fuqi punëtore më e shkathët.

Busulla.COM mbështet gjithëpërfshirjen e komuniteteve RAE dhe Serb, pasi që janë implementuar disa projekte me shkollat dhe komunat përkatëse.

Busulla.COM

Platforma zyrtare e MASH për orientim profesional,
edukim dhe këshillim në karrierë.

Fillo Këtu



Analiza e indikatorëve të edukimit dhe tregut të punës



Zhvillimi i analizës për situatën aktuale: Studimi i barometrit vjetor me nxënës, hulumtimet e kryera me biznese, intervistat e kryera me mësimdhënës dhe menaxhmentin e shkollave.



Institucionet arsimore janë të pajisura me mbështetje dhe njohuri teknike për të kuptuar nevojat e tregut të punës për njohuri dhe trajnime, si dhe monitorimi dhe vlerësimi i implementimit të politikave dhe strategjive.



Gjurmimi i progresit të nxënësve dhe studentëve të cilët vazhdojnë edukimin e mëtejshëm ose kalojnë në tregun e punës, për të kuptuar përshtatshmërinë e kurrikulës, kërkesat e tregut të punës, krijimin e storieve të suksesit, etj.



Gjenerimi i raporteve dhe trendëve për ministritë dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit për të informuar politikë-bërjen.

Aktivitetet e Forumit Nacional për Edukim në Karrierë

Përbëhet nga katër grupe të veçanta të interesit, duke përfshirë:



Kolegjet dhe Universitetet (p.sh. Qendra për Zhvillim të Karrierës në Universitetin e Prishtinës): Koordinimi i aktiviteteve me nxënësit e shkollave të mesme të larta (sesione informuese, vizita në kampus, vegla të reja, etj.).



Qendrat e Karrierës dhe Klubet e Karrierës në shkollat e mesme profesionale: Të ngritura nga EYE dhe GIZ, KCDF ofron koordinimin e aktiviteteve, ngritjen e kapaciteteve, qëndrueshmërinë dhe replikimin e të njëjtave.



Klubet e Karrierës në gjimnaze: Të ngritura nga ASSET – USAID, KCDF ofron koordinimin e aktiviteteve, ngritjen e kapaciteteve, qëndrueshmërinë dhe replikimin e të njëjtave.



Klubet e Karrierës në shkollat e mesme të ulëta: Të ngritura nga GIZ, KCDF ofron koordinimin e aktiviteteve, ngritjen e kapaciteteve, qëndrueshmërinë dhe replikimin e të njëjtave.

Objektivat e Forumit Nacional për Edukim në Karrierë



Identifikimi i çështjeve për adresim nga politika, terminologjia e përbashkët për orientim në karrierë dhe sigurimi i bashkëpunimit ndërinstytucional në aktivitete, ngjarje dhe projekte.



Zhvillimi i kornizave të kompetencave për menaxhimin e karrierës për qytetarë dhe praktikues të orientimit në karrierë dhe struktura që mbështesin ofrimin e orientimit në karrierë gjatë gjithë jetës.



Definimi i standardeve të kualitetit si dhe shpërndarja e inovacionit dhe praktikave më të mira nga shtete dhe organizatave të ndryshme.



Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, siç janë: ICCDPP, International Career Guidance Practitioners Community, Network for Innovation in Career Guidance and Counselling in Europe (NICE), etj.



KCDF planifikon të mbaj forumin vjetor me palët e interesit nga sektori publik, shoqëria civile dhe sektori privat.

**FALEMINDERIT PËR
VËMENDJE!**



Kosovo Career
Development Foundation

Rruga Xheladin Hana, Prishtinë

Numri kontaktues: +383-44-507-575

E-mail adresa: info@koscdf.org

Ueb faqja: www.koscdf.org